



RAPORT PËRMBLEDHËS

**KONSULTIMI PUBLIK ME ORGANIZATA
ANËTARE TË PLATFORMËS CIVIKOS
GJATË VITIT 2017**

Prishtinë, Qershor 2018

Autor: Visar Kelmendi

Publikoi: Platforma CiviKos

Prishtinë, Qershor 2018

Ky botim është realizuar me përkrahjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë. Përmajtja e këtij botimi është përgjegjësi e CiviKos-it dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë.



RAPORT PËRMBLEDHËS

KONSULTIMI PUBLIK ME ORGANIZATA
ANËTARE TË PLATFORMËS CIVIKOS
GJATË VITIT 2017

Përmbajtja

- 5 Hyrja
- 6 Platforma CiviKos
- 7 Zbatimi i Standardeve Minimale për Procesin e Konsultimit Publik Gjatë Vitit 2017
- 8 Pjesëmarrja e Organizatave Anëtare të CiviKos në Procesin e Konsultimit Publik
- 11 Perceptimet dhe përvojat e OSHC-ve rreth pjesëmarrjes në procesin e konsultimit publik përmes anketës së zhvilluar nga CiviKos
- 12 Vështrime dhe Rekomandime
- 12 Aspekte teknike
- 13 Aspekti informues, kohor dhe i planifikimit
- 14 Procesi i informacionit kthyes
- 15 Procesi i miratimit qeveritar të ligjeve dhe dokumenteve të tjera që i nënshtrohen konsultimit publik

Hyrje

Shoqëria Civile si tërësi e organizatave joqeveritare që përfaqësojnë interesin dhe vullnetin e qytetarëve përmes përfshirjes aktive në politikbërje kontribuon në avancimin e interesit qytetar dhe zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë në vend.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e konsultimeve publike përveç se ndikon në ngritjen e cilësisë së dokumenteve strategjike, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore gjithashtu ndikon në hapjen gjithnjë e më të madhe të autoriteteve publike karshi qytetarëve duke ngritur kështu nivelin e transparencës karshi qytetarëve dhe përmbushur standardet demokratike të pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje.

Nga viti 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës duke u bazuar në “Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013 – 2017”¹ dhe në përputhshmëri me objektivin e parë të kësaj strategjie në marrëveshje me Platformën CiviKos është zotuar për të dërguar në konsultim publik, draft strategjitë, draft ligjet, udhëzimet administrative dhe koncept dokumentet tjera qeveritare. Këto dokumente janë dërguar në adresë të Platformës CiviKos e cila përmes sekretariatit të saj ka bërë shpërndarjen përmes postës elektronike të këtyre dokumenteve tek organizatat e shoqërisë civile, ndërsa përmes buletinit elektronik tek të gjithë të interesuarit e regjistruar për të pranuar buletin e Platformës CiviKos. Duke filluar nga Korriku 2015, dokumentet Qeveritare janë shpërndarë në pesë qendrat rajonale të Platformës CiviKos të cilat i kanë shpërndarë më tej në mënyrë kapilare tek organizatat tjera në tërë

1 “Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013 – 2017 dhe Plani i Veprimit 2013 – 2017” <http://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-58359a7166b95.pdf>

territorin e Republikës së Kosovës. Sekretariati i CiviKos-it në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve të kaluara ka bërë monitorimin e procesit të konsultimit publik nga ana e ministrive të linjës, duke monitoruar respektimin e periudhës kohore për konsultim publik, respektimin e dy gjuhësisë të gjitha dokumenteve të publikuara për konsultim publik sipas Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011².

Në përputhje me objektivin e parë strategjik³ për të siguruar dhe fuqizuar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit gjatë vitit 2016 janë ndërmarrë hapa konkret për realizimin e masës 1 dhe 2 të kësaj strategjie.

Me 29 Prill 2016 është miratuar “Rregullorja (QRK) Nr. 05/2016 Për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik”⁴. Në kuadër të nën objektivave strategjik 1.1 për hartimin dhe plotësim-ndryshimin e legjislacionit bazë/referues për përfshirje të OShC-ve në hartim dhe zbatim të politikave dhe 1.2 për përcaktimin e standardeve të përfshirjes së OShC-ve në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit, kjo rregullore vendos standardet të cilat duhet të merren parasysh nga ana e institucioneve gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit për t’iu mundësuar qytetarëve dhe shoqërisë civile që të jenë të përfshirë në formësimin e këtyre politikave dhe legjislacionit.

2 “Rregullore Nr. 09/2011 e Punës së Qeveris së Republikës së Kosovës” [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_e_punes_se_Qeverise_09.2011_\(shqip\).pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_e_punes_se_Qeverise_09.2011_(shqip).pdf)

3 “Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013 – 2017 dhe Plani i Veprimit 2013 – 2017” <http://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-58359a7166b95.pdf>

4 Rregullore (QRK) Nr. 05/2016 Për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik” <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>

Për të identifikuar dhe matur pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në procesin e konsultimit publik, Sekretariati i CiviKos qysh nga viti 2013 realizon çdo vit hulumtim me organizatat anëtare dhe jo anëtare përmes pyetësorëve online dhe intervistave individuale me organizatat e shoqërisë civile aktive në procesin e konsultimit publik, ndërsa nga viti 2014 çdo vit publikon raportet⁵⁶⁷ rreth pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin e konsultimit publik .

Duke filluar nga viti 2017, procesi i konsultimit publik realizohet përmes platformës qeveritare⁸ online. Duke filluar nga 2 Shkurti 2017 kur është publikuar dokumenti i parë për konsultim deri më 22 Dhjetor 2017 në platformën online janë publikuar në total 207 dokumente të ndryshme qeveritare nga Zyra e Kryeministrit dhe dymbëdhjetë ministri të linjës.

Platforma CiviKos përmes këtij raporti përmbledhës prezanton të gjeturat lidhur me pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në procesin e konsultimit publik, zbatimin e standardeve minimale të përcaktuara me rregullore qeveritare, realizimin e agjendës legjislative, të koncept dokumenteve dhe strategjive qeveritare. Duke u bazuar në perceptimet e organizatave të shoqërisë civile të shprehura përmes procesit të anketimit dhe intervistës në fund të këtij raporti janë përpiluar disa vështrime dhe rekomandime për të përmirësuar procesin e konsultimit publik.

5 http://www.civikos.net/repository/docs/Analize_pjesemarrja_ne_konsultime_publike_2013_-_2014_211192.pdf

6 http://www.civikos.net/repository/docs/Raport_Permbledhes-Konsultimi_publik_712101.pdf

7 http://www.civikos.net/repository/docs/Konsultimi_publik_2016_final_233714.pdf

8 <http://konsultimet.rks-gov.net>

Platforma CiviKos

Platforma CiviKos është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë e nisur në fillim të vitit 2007, që ka për qëllim krijimin e një mjedisi të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të Shoqërisë Civile dhe Qeverisë së Republikës Kosovës. Platforma CiviKos, pas një procesi të gjatë konsultimi e me pjesëmarrjen e mbi 130 organizatave të shoqërisë civile, më 9 Nëntor 2007 ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit mes Qeverisë së Kosovës dhe shoqërisë civile (të përfaqësuar nga Platforma CiviKos). Ky memorandum paraqet dokumentin e parë formal që parasheh përkushtimin e dyanshëm për një bashkëpunim institucional dhe partneritet të mirëfilltë në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Shoqërisë Civile. Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 05 korrik 2013 ka aprovuar Strategjinë Qeveritare dhe Planin e Veprimit për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017. Gjatë muajit shtator-tetor 2014 është bërë themelimi i Këshillit për Zbatim të Strategjisë Qeveritare, dhe janë themeluar grupet punuese për katër objektivat Strategjike.

9 "Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013 – 2017 dhe Plani i Veprimit 2013 – 2017" <http://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-58359a7166b95.pdf>

Zbatimi i Standardeve Minimale për Procesin e Konsultimit Publik Gjatë Vitit 2017

Gjatë vitit 2017 në platformën online për procesin e konsultimit publik janë publikuar gjithsej 207 dokumente qeveritare, ku 39 janë Projektligje,

22 Koncept-dokumente, 6 Plane të Veprimit, 43 Rregullore, 87 Udhëzime Administrative, 5 Strategji dhe 5 dokumente tjera si Kode të punës.




Fig. 1: Llojet e dokumenteve qeveritare të publikuara në platformën online për procesin e konsultimit publik gjatë vitit 2017.




Fig. 2: Nga 207 dokumente qeveritare të vendosura në Platformë gjatë vitit 2017 18 komente kanë ardhur nga organizata të shoqërisë civile, 3 komente nga qytetarët dhe 7 komente nga Zyra e Komisionerit të Gjuhëve.

Pjesëmarrja e Organizatave Anëtare të CiviKos në Procesin e Konsultimit Publik

Nga pyetësi online i dërguar tek organizatat anëtare të CiviKos janë përgjigjur 17 organizata anëtare. Rezultatet e mëposhtme pasqyrojnë mendimet dhe qëndrimet e organizatave anëtare

të CiviKos rreth procesit të konsultimit publik dhe përdorimit të platformës online për procesin e konsultimit publik.

A jeni të njoftuar rreth Rregullorës për Standardet Minimale për procesin e Konsultimit Publik




Fig. 3: 29% e organizatave që janë përgjigjur kanë deklaruar se nuk kanë informata për rregullorën 47% se janë të njoftuar me rregulloren, dhe -2% se kanë qenë të përfshira në proces të hartimit.

A jeni të regjistruar në Platformën online për procesin e konsultimit publik, dhe a i pranoni njoftimet për dokumentet që vendosën për konsultim publik?




Fig. 4: Në pyetjen se a janë të regjistruara në platformën online 6% kanë deklaruar se janë regjistruar në platformë, 29% se nuk janë regjistruar, 53% janë regjistruar dhe pranojnë informata rregullisht, ndërsa 12% kanë deklaruar se janë regjistruar por nuk pranojnë njoftime për dokumentet që vendosën në platformë.

A keni marrë pjesë në trajnime për procesin e konsultimit publik?




Fig. 5: Sa i përket pjesëmarrjes në trajnime 53 % deklarojnë se kanë marrë pjesë në trajnime për procesin e konsultimit publik, ndërsa 47 % nuk kanë marr pjesë në trajnime.

Cilat janë arsyet që nuk jeni regjistruar në Platformë (përgjigjuni në këtë pyetje vetëm nëse nuk jeni të regjistruar në platformë)




Fig. 6: Sa i përket arsyeve pse nuk janë regjistruar në platformë, nga totali i organizatave që janë përgjigjur në pyetje 22% mendojnë se kontributi i tyre nuk merret parasysh, 33% kanë deklaruar se nuk kanë ekspertizë, 11% se nuk kanë kohë dhe 22% nuk ka qenë të informuar për ekzistimin e kësaj platforme apo ndonjë arsye tjetër.

Si e vlerësoni funksionimin e kësaj platforme?

(Nëse jeni të regjistruar në platformën online për procesin e konsultimit publik)




Fig. 7: Nga të gjitha organizatat që janë përgjigjur, 91% mendojnë se platforma është lehtë e përdorshme dhe 9% mendojnë se është vështirë e përdorshme.

A keni dhënë komente në ndonjërin nga dokumentet qeveritare të vendosura në platformën online për konsultim publik gjatë vitit 2017?



Fig. 8: Nga organizatat që i janë përgjigjur pyetësorit, 40% prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë dhënë komente me shkrim në platformë, 53% disa herë dhe 7% vetëm një herë.

A keni pranuar përgjigje nga zyrtaret përgjegjës për përfshirjen ose jo të kontributeve tuaja? (Nëse keni dhënë kontribute me shkrim)




Fig. 9: Nga organizatat që kanë dhënë komente 8% kanë deklaruar se kryesisht kanë pranuar komente, 23% nuk e dinë, 54% nuk kanë pranuar komente dhe 15% kanë deklaruar se gjithmonë kanë pranuar përgjigje.

A keni qenë të përfshirë gjatë vitit 2017 në hartim të legjislacionit apo akteve nënligjore në ndonjë formë tjetër?




Fig. 10: Sa i përket përfshirjes së organizatave në hartim të legjislacionit, 37% kanë deklaruar se kanë qenë të përfshira përmes dëgjimeve publike, 42% kanë qenë pjesë e grupeve punuese, 15% kanë dërguar komente përmes e-mail, 5% nuk kanë qenë të përfshira dhe 5% nuk kanë qenë të njoftuar.

Perceptimet dhe përvojat e OSHC-ve rreth pjesëmarrjes në procesin e konsultimit publik përmes anketës së zhvilluar nga CiviKos

Duke filluar nga viti 2014 Platforma CiviKos zhvillon anketim të rregullt me organizatat anëtare dhe jo anëtare për pjesëmarrjen e tyre në procesin e konsultimit publik. Këtë vit gjatë periudhës 14 – 26 Mars është shpërndarë pyetësori online te 220 organizata të shoqërisë civile, prej të cilave 216 organizata anëtare të Platformës CiviKos dhe 4 organizata jo anëtare. Me synimin që përtej të dhënave sasiore të mblidhen edhe të dhëna kualitative mbi procesin e konsultimit publik, në pyetësorin e shpërndarë kemi shtruar pyetjen në vijim:

“Ju lutemi shfrytëzoni këtë hapësirë për të dhënë mendimin tuaj rreth procesit të konsultimit publik që Qeveria e Kosovës e organizon me shoqërinë civile në Kosovë”

Nga përvojat dhe perceptimet e shumta që kemi marrë, kemi përzgjedhur të atilla që ndahen nga shumë organizata dhe të tjera që janë më specifike dhe kanë të bëjnë me fushëveprimin e organizatës në fjalë.

Më poshtë mund ti gjeni disa nga to:

“Nuk kam qenë e informuar për ekzistimin e kësaj Platforme.”

“Platforma është në nivel të kënaqshëm por kërkohet më shumë vëmendje për afatet kohore nga dhënia e komenteve dhe rekomandimeve deri te miratimi i ligjit e më pas deri te fillimi i imple-

mentimit të ligjit. Konstatohet se ka vonesa të mëdha në secilën fazë dhe kjo shkakton humbjen e vëmendjes.”

“Vlerësoj se Qeveria akoma nuk është duke i trajtuar me seriozitet konsultimet publike. Ministrinë akoma nuk kanë demonstruar përgjegjshmëri dhe seriozitet sa i përket procesit të konsultimit, për arsye se mungon pjesa e kthimit të përgjigjeve nëse kontributet e shoqërisë civile janë marrë parasysht, apo për të dhënë shpjegimet me shkrim për refuzim apo mos-përfshirje të kontributit.”

“Mendoj se kontributi im nuk merret parasysht.”

“S’ka motiv për të dhënë komente meqenëse ato nuk merren parasysht dhe mungon informata kthyesë për komentet e dhëna. Prandaj konsiderojmë se dhënia e kontributit është e pa dobishme.”

“Prej momentit që jemi regjistruar nuk ka pasur dokumente që ndërliken me punën tonë.”

“Sa i përket procesit të konsultimit publik, shpeshherë thirrjet bëhen në afate të shkurtra gjë që vështirëson dhënien e kontributit. Konsideroj se Rregullorja për Standarde Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, jo gjithëherë respektohet për vet faktin se është dokument i ri, prandaj mendoj se duhet të ketë një informim më të madh publik për ekzistimin e kësaj rregullore.”

Vështrime dhe Rekomandime

Duke u bazuar në të dhënat e mbledhura përmes procesit të anketimit, si dhe përvojave dhe perceptimeve të organizatave të intervistuar, raportit të përgatitura nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile “Under Construction - Platforma Online për Konsultime Publike gjatë vitit 2017”¹ si dhe “Raportit Vjetor për Konsultime me Publikun në Qeverinë e Republikës së Kosovës”² të publikuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, në vijim kemi përgatitur një vështrim të gjendjes aktuale të platformës dhe procesit të konsultimeve dhe disa rekomandime për përmirësimin e këtij procesi në aspektin kuantitativ të pjesëmarrjes së organizatave dhe kualitativ të përmbajtjes së kontributeve të organizatave të shoqërisë civile.

1 http://www.kcsfoundation.org/repository/docs/03_04_2018_7635999_Platforma_Online_gjate_2017_KCSF.PDF

2 <http://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-5af-95b62d6637.pdf>

Aspekte teknike

Duke u bazuar në të gjeturat nga anketimi dhe raportet tjera të publikuara gjatë vitit të parë të funksionimit të platformës online janë vërejtur probleme të aspektit teknik të funksionimit. Problemet janë në procesin e regjistrimit dhe në procesin e shpërndarjes së njoftimeve, prandaj ne rekomandojmë që të punohet në:

- Identifikimin dhe përmirësimin e të gjitha pengesave në procesin e regjistrimit të përdoruesve të rinj duke evituar kështu pengesat në procesin e regjistrimit.

Rekomandimet për përmirësimin e procesit të konsultimit publik janë të fokusuara rreth platformës online për konsultime publike dhe nuk thellohen në Rregullore për Standarde Minimale³. Për të shkoqitur sa më mirë dhe për efekt të qartësisë rekomandimet janë kategorizuar në katër kategori si në vijim:

1. Rekomandime të aspektit teknik
2. Rekomandime të aspektit informues, kohor dhe të planifikimit
3. Rekomandime për procesin e informacionit kthyes
4. Rekomandime për procesin e miratimit të projekt-ligjeve dhe dokumenteve të tjera

3 Rregullore (QRK) Nr. 05/2016 Për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik” <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>

- Zhvillimin e procesit të automatizuar për njoftime të përdoruesve të platformës për secilin proces të hapur të konsultimit publik, duke e pamundësuar që shërbyesit civil të ketë në diskrecion anashkalimin e dërgimit të njoftimit të palët e interesuara.
- Në kuadër të procesit të njoftimit të ketë emërtime të veçanta për secilin njoftim të dërguara nga platforma, duke evituar emërtimin standard dhe të përgjithësuara që nuk përmbajnë informacion për përmbajtjen e njoftimit.

Aspekti informues, kohor dhe i planifikimit

Procesi i konsultimit publik ka për qëllim mbledhjen e rekomandimeve cilësore nga shoqëria civile, grupet e interesit dhe publiku i gjerë. Informimi i publikut për ekzistimin e platformës dhe të standardeve minimale është hapi i parë, ndërsa publikimi i agjendave legjislative, të planifikimit për dokumente strategjike dhe koncept dokumenteve të tjerë, mundëson përgatitjen adekuate dhe ngritje cilësore të kontributeve nga pjesëmarrësit.

Në baze të gjeturave rekomandojmë që gjatë vitit aktual dhe viteve në vijim të punohet në:

- Zhvillimin e fushatave informuese për ekzistimin e platformës elektronike të konsultimeve publike të fokusuar te OJQ-të, qytetarët dhe palët tjera të interesit.
- Intensifikimin e procesit të komunikimit me organizata ombrellë dhe organizata të tjera që përfaqësojnë palët e interesit, si organizatat e shoqërisë civile, odat ekonomike, sindikatat, organizatat që përfaqësojnë profesione të lira etj.
- Intensifikimin e përpjekjeve nga Zyra për Qeverisje të Mirë për ngritjen e kapaciteteve të ministrive në standardet minimale për procesin të konsultimeve publike.
- Përmes informimit, trajnimeve dhe mentorimit të ngritën kapacitetet e pesë ministrive të cilat nuk kanë publikuar raporte apo nuk kanë shfrytëzuar fare platformën gjatë vitit 2017 me theks të veçantë në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.
- Procesi i konsultimit publik i cili nuk limitohet vetëm në platformën online, të jetë i hapur dhe gjithëpërfshirës. Përkatësisht, njoftimet për grupe punuese, tryeza të rrumbullakëta dhe takime/dëgjime publike të jenë të vendosura në platformën online, në afate adekuate dhe me informacion të plotë mbi kohën dhe lokacionin si dhe të përfshijnë draft dokumentet që janë subjekt i diskutimit.
- Të intensifikohen përpjekjet nga të gjitha ministrinë për ngritjen e pjesëmarrjes nga shoqëria civile dhe grupet e interesit në diskutime publike nga momenti i hartimit të koncept dokumentit e deri në përpilimin e draftit të fundit të projektligjeve.
- Zyra për Qeverisje të Mirë të punoj me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të publikuar çdo fillim vit projekt planet e akteve nënligjore dhe projekt aktet normative të secilës ministri së bashku me afatet kohore.
- Angazhim i shtuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë në sigurimin e një procesi kualitativ të konsultimit publik. Përveç sigurimit të plotësimin formal të standardeve, kërkohet qasje pro-aktive në sigurimin e përfshirjes së palëve të interesit në proces të konsultimeve publike.

Procesi i informacionit kthyes

Nga hulumtimi i zhvilluar nga Platforma Civikos mund të konstatojmë se shoqëria civile dhe grupet e tjera të interesit e shohin procesin e konsultimit publik si proces me rëndësi që u mundëson pjesëmarrjen aktive në bërjen e politikave sektoriale dhe orientimin e mendimit strategjik ka fushat e tyre të veprimit. Ngritja e nivelit të pjesëmarrjes përmes fushatave informuese dhe promovuese mund të zbehet me kohë nëse procesi i informacionit kthyes është i mangët apo inekzistent.

Bazuar në rekomandimet, komentet e pranuar dhe raportet tjera të publikuara rekomandohet me sa vijon:

- Në rast të refuzimit të propozimeve të dhëna nga shoqëria civile dhe grupet e interesit për ndryshim të projektligjeve apo dokumenteve tjera subjekt i konsultimit publik, të jepen arsyetime me shkrim për refuzimin e propozimit të dhënë.
- Raportet e procesit të konsultimit të përfshijnë propozimet e cituara nga shoqëria civile duke mos ju ndryshuar përmbajtja e tyre. Ndërsa në rast se i njëjti koment është dhënë nga disa organizata, në raport të përfshihen të gjithë emrat e organizatave komentuese.
- Platforma e Konsultimeve Publike të jetë në gjendje që në mënyrë të automatizuar të prodhoj raporte statistikore të qasshme për publikun e të cilat pasqyrojnë të dhënat mbi shfrytëzimin e platformës nga publiku dhe të dhëna krahasuese mes agjendave legjislative bie fjala dhe realizimit të tyre për vitin e dhënë.
- Ministritë përkatëse të publikojnë në Platformën e Konsultimit publik një versionin final të ligjit apo dokumentit që i nënshtrohet konsultimit pas shqyrtimit dhe përfshirjes së komenteve të marra gjatë konsultimit publik përmes platformës apo kanaleve të tjera të konsultimit publik.

Procesi i miratimit qeveritar të ligjeve dhe dokumenteve të tjera që i nënshtrohen konsultimit publik

Mungesa e një klauzole obliguese e cila do të bllokonte procesin e miratimit qeveritar në rast të mos plotësimit të kriterëve minimale apo edhe mos kalimit fare në proces të konsultimit publik, mund të shihet si stimul nga ministritë që në raste të caktuara dhe për interesa të përveçme procedura e konsultimit publik të anashkalohej në tërësi.

Mungesa e një klauzole obliguese e cila do të bllokonte procesin e miratimit qeveritar në rast të mos plotësimit të kriterëve minimale apo edhe mos kalimit fare në proces të konsultimit publik, mund të shihet si stimul nga ministritë që në raste të caktuara dhe për interesa të përveçme procedura e konsultimit publik të anashkalohej në tërësi.

Për të pakësuar dhe më pas eliminuar situata të tilla të cilat mund të shpeshtohen në mungesë të

veprimeve të menjëhershme nga ana e Zyrës për Qeverisje të Mirë, rekomandojmë me sa vijon:

- Zhvillim i kuadrit të nevojshëm ligjor nga ana e Zyrës për Qeverisje të Mirë për kushtëzimin e miratimit qeveritar të gjitha dokumenteve të cilat janë subjekt i konsultimit publik dhe nuk kanë kaluar përmes këtij procesi apo nuk i kanë plotësuar kriteret minimale të konsultimit publik.
- Ngritjen e kësaj problematike në nivel të ministrive dhe bashkëpunimin me departamentet ligjore përkatëse për të garantuar që secili dokument qeveritar që i nënshtrohet konsultimit publik të kalojë nëpër këtë proces para se të marrë miratim qeveritar.

Mbështetur nga:



Kingdom of the Netherlands

Zbatuar nga:

